



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Administratori

Nr. 4443/1 Prot

Shkodër, më 09 . 12 .2025

FTESA PËR KUOTIM

Titulli i Projektit: "Supporting development of TransCultural Competence for healthcare professionals in the Western Balkans - Project number: 101128620"

Titulli Kontratës: "Blerje paisje teknike - mjeksore "

1. Jeni i ftuar të paraqisni çmimet e kuotuar tuaja për furnizimin me artikujt bashkëngjitur kësaj ftese.
Informacioni për specifikimet teknike dhe sasi të kërkuara është dhënë në shtojcën 1 bashkëngjitur kësaj ftese.
2. Ju duhet të kuotoni për të gjithë artikuj sipas kësaj ftese. Kuotimet e çmimit do të vlerësohen për të gjithë zërat së bashku dhe kontrata do t'i jepet firmës që ofron koston totale më të ulët të vlerësuar të të gjithë artikujve së bashku.
3. Ju do të paraqisni një origjinal të Kuotimit të Çmimit me Formularin e Ofertës dhe dokumentet ligjore të kualifikimit (bashkëngjitur). Kuotimi juaj sipas kërkesës duhet të mbyllet në një zarf dhe të adresohet dhe të dërgohet në adresën e mëposhtme:

UNIVERSITETI "L.GURAKUQI"

Adresa: "Sheshi 2 prilli" Shkodër

4. Kuotimi juaj perpilohet në 2 gjuhë shqip dhe anglisht.
5. Afati përfundimtar për marrjen e Kuotimeve tuaja nga Enti Prokurues me adresën e treguar në paragrafin 3 është: Date: 08.01.2026, ora 09.00, Universiteti L.Gurakuqi, protokoll arkiva e U.S.H me poste me shenimin Ofertë për prokurimin e projektit për projektin me titull "Supporting development of TransCultural Competence for healthcare professionals in the Western Balkans - Project number: 101128620"
6. Kuotimet tuaja duhet të paraqiten sipas instruksioneve të mëposhtme dhe në përputhje me dhënat bashkëlidhur. Termat dhe Kushtet e Furnizimit të bashkëlidhura janë pjesë integrale e Kontratës.
 - (i) ÇMIMET: Çmimet duhet të kuotohen për dërgese deri në magazinën e U.S.H – së (vendi i destinacionit)



- (ii) **VLERËSIMI I KUOTIMEVE:** Ofertat për të cilat vendoset se janë substancialisht në përputhje me specifikimet teknike do të vlerësohen duke krahasuar çmimet e tyre .

Gjatë vlerësimit të kuotimeve Enti Prokurues do të përcaktojë për çdo propozim çmimin e vlerësuar duke axhustuar kuotimin e çmimit dhe duke bërë ndonjë korrigjim për gabime aritmetike si më poshtë:

(a) aty ku ka mospërputhje midis shumave në shifra dhe në fjalë, do të merren parasysh shumat me fjalë;

(b) aty ku ka mospërputhje midis çmimit njësi dhe totalit të artikullit të linjës që rezulton nga shumëzimi i çmimit njësi me sasinë, çmimi njësi siç kuotohet duhet të merret parasysh;

(c) në qoftë se furnizuesi refuzon të pranojë korrigjimet, kuotimi i tij do të refuzohet.

- (iii) **DHËNIA E URDHËRIT TE BLERJES:** Urdhëri i Blerjes do t'i jepet ofertuesit që ofron çmimin më të ulët të vlerësuar dhe që është në përputhje me standardet e kërkuara të mundësive ligjore financiare dhe teknike. Ofertuesi i suksesshëm do të nënshkruajë një kontratë sipas formularit të bashkëlidhur të Kontratës dhe afateve dhe kushteve të furnizimit.

- (iv) **VLEFSHMËRIA E OFERTËS:** Kuotimet tuaja do të jenë të vlefshme për një periudhë prej shtatëdhjetë e pesë ditësh (75) nga afati i fundit i marrjes së kuotimeve i përcaktuar në paragrafin 5 të kësaj Ftese për Kuotim.

7. Informacioni i mëtejshëm mund të merret prej:

Dr. Julian Kraja

Kordinator i projektit

Adresa: UNIVERSITETI "L.Gurakuqi"

Tel. & Fax.

E-mail: julian.kraja@unishk.edu.al

8. Ju lutem konfirmoheni marrjen e kësaj ftese.

(Shënim: Në rast mospërputhje midis çmimit të njësisë dhe çmimit total që rrjedh nga çmimi për njësi, do të merret në konsideratë çmimi për njësi)

Kriteret kualifikuese ligjore, financiare për operatorit ekonomik që do kuotojë:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1.Deklaratë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

d) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

e) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë nën përgjegjësinë e tij ligjore se mallrat objekt prokurimi që do të ofertojë nuk janë të assembluara në Shqipëri, të jenë të reja dhe origjinale.

3. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike duke specifikuar garancinë.

4. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit

5. Deklaratë e operatorit që merr persiper që për të gjithë artikujt e preventivit të realizohet furnizim vendosja sipas kërkesave të AK duke respektuar parametrat e detajuar si dhe venien në punë në testimin funksional përfundimtar të tyre (të gatshme për përdorim nga stafi i projektit të USH-se)

6. Formularin e Ofertës ekonomike e teknike.

7. Furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet

Keto furnizime të ngjashme do të vertetohen me dokumentacionin si më poshtë:

-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore: Kontratë, faturë e vërtetimit realizimi

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, kontratë dhe fatura tatimore e shitjes ku shënohen artikujt, datat, shumat.

Në vëmendje të operatorëve ekonomike

- **Gara do të vazhdojë nëse paraqiten minimumi 3 ofertues.**
- Vlerësimi i ofertuesve brenda 5 ditëve nga paraqitja e ofertave.
- Ankimimi brenda 7 ditëve nga klasifikimi përfundimtar.
- Mbas shqyrtimit të ankesave në rrugë administrative, brenda 5 ditëve bëhet nënshkrimi i kontratës, ku ofertuesi fitues duhet të paraqesë formularin e sigurimit të kontratës.
- Afati i lëvrimit 30 ditë.
- Çdo dokument i dorëzuar duhet në dy gjuhë shqip dhe anglisht (original dhe/ose i noterizuar)

Administratori

Enejda Vadohej





Lista e paisjeve me specifikimeve

Emertimi i pasljes	Specifikimet	Sasia
Sistem Gjithëpërfshirës Trajnimi në Emergjencë	Karakteristikat: ★ Ky simbol tregon se funksionet mund të përdoren vetëm kur manekini përdoret me pajisje shtesë opsionale. Koka dhe qafa: 1. Simulimi i shenjave vitale: vëzhgim i pupilës, ekran LCD për pupilën; simulim i pulsit të arteries karotide, femorale dhe radiale; riprodhim i gjallë i tingullit të ankesave të pacientit, kollitjes dhe të vjellave. 2. Modaliteti i frymëmarrjes: frymëmarrje normale, frymëmarrje me psherëtimë, frymëmarrje Cheyne-Stokes, frymëmarrje Kussmaul-Kien dhe frymëmarrje Biot. 3. Frymëmarrje spontane realiste: vërehet lëvizja e krahavorit gjatë frymëmarrjes; frekuenca dhe thellësia e frymëmarrjes mund të rregullohen. 4. Menaxhimi i rrugëve të frymëmarrjes: hapje e rrugës së ajrit me prirje të kokës dhe ngritje të nofullës; paralajmërim zanor nëse ushtrohet presion mbi dhëmbët; zbulim i pozicionit të intubimit përmes auskultimit. Krahavori dhe barku: 1. Trajnimi i operacionit CPR: ofron mënyra të shumta ventilimi: gojë më gojë, gojë më hundë, BVM më gojë; monitorim elektronik i hapjes së rrugës së ajrit, numrit të insuflimeve, frekuencës, vëllimit dhe numrit të kompresioneve, frekuencës, pozicionit dhe thellësisë; pas shpëtimit të suksesshëm, gjendja e pupilës rikthehet normale, rikthehet pulsi i arteries karotide dhe frymëmarrja spontane. ★ Defibrilim dhe stimulim simuluar: përdorur me GD/J880 defibrilator stimulator për të realizuar defibrilim dhe stimulim; energjia e defibrilimit është e përzgjedhshme. ★ AED simuluar: përdorur me GD/AED99F defibrilator të jashtëm automatik për trajnimin AED; ofron butona elektrodash; zbulim	1 (një)



automatik i ritmit të zemrës dhe analizë nëse nevojitet defibrilim.

★ **Monitorim ECG simuluar:** monitorim i oksigjenit në gjak me sensor në gisht; monitorim simuluar ECG realizohet kur përdoret me GD/J115 monitor ECG simuluar me shumë parametra.

2. **Auskultim:** ofron dhjetëra tinguj, duke përfshirë tinguj normalë të zemrës, tinguj jonormalë të zemrës, tinguj normalë të frymëmarrjes, tinguj jonormalë të frymëmarrjes, tinguj normalë të zorrëve, tinguj jonormalë të zorrëve.
3. **Shpime:** shpim torakal, shpim palce kockore.
4. **Laptop (Basic)**

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE

Pikët Min. për Procesorin	5500 Pikë
sipas: cpubenchmark.net	
Min Proc. Rating	
According to:	
cpubenchmark.net:	
“Chipset”:	Intel ose Ekuivalent
“RAM”:	8 GB, DDR4 min. 2133 MHz, Non-ECC
Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:	256 GB SSD
“Graphics”:	Integrated Graphics with 1 GB Video Memory
Ekrani “Display”:	15.6” LED FHD (1920 x 1080), Anti Glare
Bateria “Battery”:	Min. 45 Wh
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit	Min. (3) porta USB nga të cilat min. (2) USB 3.0
“Ports”:	(1) DisplayPort/HDMI
	(1) Integrated Mic.
	(1) Integrated HD Web Camera
	(1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack



Rrjeti "Networking":

10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45);

"Sound":

Wireless 802.11ac
(Kompatibël me 802.11 b/g/n);
Bluetooth min. V4.0

Sistemi i Operimit
"Preinstalled Licensed
O.S.":

Integrated , (2) x built-in
speakers (stereo)
OEM Windows 11 64-bit
Professional

Tastiera "Keyboard":

QWERTY

"Pointing Device":

Touch Pad

Siguria "Security
Management":

Embedded Security TPM 2.0

AKSESORËT

Kabëll "Power Cord":

Po, European

Ushqyesi "Recharger":

Po

"Mouse":

Po, i të njëjtës Markë me
Laptopin

Çanta "Carrying Bag":

Po, nga Prodhuesi. E
përshtatshme për Laptop dhe
aksesorët e tjerë.

"Recover":

Recover Partition

GARANCIA

Periudha e Mbulimit të

3 Vjet

Garancisë "Warranty":

Gjymtyrët:

- Matje e tensionit të gjakut, venopunksion dhe injeksion intramuskular në muskujt vastus lateralis; venat e krahut shumë realiste; lëkura dhe enët e gjakut janë të zëvendësueshme.

Softueri:

1. **Përdorimi i pompës simuluese të injeksionit/infuzionit:** animacione multimediale tregojnë procedurat e përdorimit të pompës së injeksionit dhe asaj të infuzionit; gjatë operimit mund të zgjidhen barna.

SHKODËR

2. **Trajnim dhe ekzaminim:** mbështetje për ECG, skena emergjente, raste, trajnim dhe testim për CPR.
3. **Skenarë emergjentë për trajnim/vlerësim:** dhjetëra skena emergjente të disponueshme, që mbulojnë VF, VT pa puls, aktivitet elektrik pa puls; këto ndihmojnë mjekët të praktikojnë procedurat emergjente për sëmundje të ndryshme të zemrës.
4. **Ofron trajtime të shumta me barna dhe ekzaminime tipike ndihmëse:** radiografi të krahavorit, ekografi, ECG dhe ECG me 12 derivime, etj.
5. **Redaktim skenarësh/rasteve:** animacioni riprodhon gjallërisht skena reale emergjente; rastet emergjente mund të redaktohen nga vetë përdoruesi; ndryshimet patologjike dhe procesi i operimit nga studentët regjistrohen në softuer.
6. **Operacioni PETCO₂:** konfirmon pozicionin e intubimit trakeal dhe monitoron vlefshmërinë e operacionit të ringjalljes.

Përbërësit:

Hardwer:

1. Manekin i rritur ACLS
2. Njësi simulimi për matjen e presionit të gjakut GD/HS7
3. BVM, stetoskop, laringoskop, kanulë trakeale, set transfuzioni, kompresor ajri mjekësor
4. Laptop

Softuer:

1. Softuer trajnimi ACLS V2.0
2. Softuer për redaktimin e skenarëve ACLS V2.0

Administratori

Enejda Vadohej



